

**UDHËZIM**  
**Nr. 4 , datë 31.12 2020**

**MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORËVE  
TË TURIZMIT DETAR**

*(ndryshuar me udhëzimin nr. 1, datë 19.9.2023)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 43, datë 27.4.2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”,

**UDHËZOJ:**

**I. TË PËRGJITHSHME**

1. Përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojë operatori turistik për ushtrimin e aktiviteteve të turizmit detar, si dhe procedurës për certifikimin si “Operator i turizmit detar”, sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”.

2. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 43, datë 23.4.2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Certifikatë”, dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, i cili tregon se një subjekt është i certifikuar për të vepruar si operator i turizmit detar.

b) “Komisioni”, Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike, i cili funksionon sipas ligjit nr. 93/2015, të ndryshuar dhe të akteve nënligjore përkatëse.

3. Asnjë subjekt nuk mund të veprojë, të ofrojë shërbime si operator i turizmit detar ose të përdorë emërtimin “Operator i turizmit detar” në Republikën e Shqipërisë, nëse nuk është pajisur me certifikatë sipas këtij udhëzimi.

**II. KRITERET PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË “OPERATOR I TURIZMIT DETAR”**

1. Subjekti, i cili kërkon të pajiset me certifikatën e operatorit të turizmit detar, për çdo aktivitet turistik detar ose/dhe për të gjitha aktivitetet, përveç respektimit të parashikimeve të ligjit nr. 43/2020, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë i pajisur me licencë XIII.1.B, sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, si operator turistik;

b) të ketë kontratë për vendbazimin e mjeteve lundruese me një port, marinë apo një subjekt që zotëron një stacion sezonal ankorimi në Republikën e Shqipërisë;

c) të ketë një plan menaxhimi të emergjencave, sipas karakteristikave të çdo lloji aktiviteti për zonën ku do të ofrojë shërbimin;

d) të ketë në pronësi apo në përdorim mjete lundrimi turistike në gjendje teknike të përshtatshme për ushtrimin e aktiviteteve të turizmit detar, vërtetuar me certifikatën e pronësisë apo kontratë të lidhur mes palëve të noterizuar;

e) të sigurojë përgjegjësitë ndaj palëve të treta në ujërat e detit të brendshëm dhe detit territorial të Republikës së Shqipërisë;

f) të njohë dhe sigurojë zbatimin e Kodit të Etikës së Operatorit të Turizmit Detar, miratuar me urdhër ministri.

### III. DOKUMENTACIONI

1. Kërkesa për pajisjen me certifikatë duhet të përmbajë:

a) të dhënat e përfaqësuesit ligjor (emrin, mbiemrin, numrin personal, adresën e saktë, numrin e telefonit, adresën *email*);

b) të dhënat për subjektin (emrin tregtar, NIPT, numrin e licencës, adresën, numrin e telefonit, adresën *email*);

c) zonën dhe/ose zonat e ushtrimit të aktivitetit, në përputhje me zonat e miratuara nga KKT-ja, sipas nenin 6, pika 2, të ligjit 43/2020;

ç) përshkrimin e aktivitetit/aktiviteteve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 28.10.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi”;

d) vendin, datën dhe nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor.

2. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) *shfuqizuar*;

b) fotokopje të licencës XIII.1.B dhe një kopje të ekstraktit historik të QKR-së;

c) kontratën e vendbazimit lidhur midis subjektit aplikues dhe subjektit që administron vendbazimin;

d) plan menaxhimi të emergjencave të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

e) dokument që vërteton pronësinë apo kontratën noteriale, lidhur për përdorimin e mjeteve lundruese me qëllimin aktivitetin detar;

f) listë me të dhënat e mjeteve të lundrimit, në funksion të aktiviteteve që do të ofrohen (lloji i mjetit, numri i identifikimit, flamuri, kapaciteti, viti i prodhimit, personi përgjegjës, numri i kontaktit). Për mjetet me flamur të huaj, një kopje të licencës VII.4.1;

g) certifikatën e sigurisë apo të klasës së lëshuar nga shoqëria klasifikuese, sipas legjislacionit në fuqi për mjetet lundruese;

h) policë sigurimi e mjetit lundrues, të përgjegjësishë ndaj palëve të treta;

i) deklaratë të nënshkruar nga subjekti, ku angazhohet të respektojë kriteret e përcaktuara në Kodin e Etikës së Operatorit të Turizmit Detar.

### IV. PROCEDURA E APLIKIMIT DHE E SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT

1. Kërkesa me dokumentacionin, sipas kreut 3, pika 2, të këtij udhëzimi depozitohet online, nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” dhe shqyrtohet nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike.

2. Komisioni, brenda 10 ditëve pune nga data e aplikimit dhe ngarkimit të dokumentacionit në portalin qeveritar “e-Albania”, sipas pikës 2, të kreut III, nis shqyrtimin e kërkesës.

3. Në qoftë se kërkesa e subjektit për pajisjen me certifikatë nuk është në përputhje me sa parashikohet në pikat 1 deri në 2, të kreut III, Komisioni, brenda 5 ditëve pune nga data e shqyrtimit të kërkesës, njofton aplikuesin nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, për plotësimin e dokumentacionit ose korrigjimin e pasaktësive dhe i cakton atij një afat prej 7 ditë pune për paraqitjen e dokumentacionit përkatës.

4. Kur kërkesa e subjektit është në përputhje me sa parashikohet në pikat 1 deri në 2, të kreut III, Komisioni merr një mendim të specializuar nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit për kapacitetet dhe karakteristikat e zonës së kërkuar për ushtrim aktiviteti detar, brenda 10 ditëve. Për këtë të fundit, AKB-ja mund të bashkëpunojë me institucione të tjera.

5. Në përfundim të procesit të shqyrtimit, Komisioni i Standardizimit merr vendim për lëshimin ose jo të certifikatës “Operator i turizmit detar”. Vendimi i njoftohet kërkuarit nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” brenda 5 ditë pune nga data e marrjes së vendimit. Në rastet kur komisioni refuzon kërkesën për pajisje me certifikatë, vendimi duhet të jetë i arsyetuar.

6. Kundër vendimit të komisionit, i cili refuzon kërkesën për pajisje me certifikatë, mund të paraqitet ankimi në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

## V. LËSHIMI I CERTIFIKATËS “OPERATOR I TURIZMIT DETAR”

1. Brenda 5 ditëve nga data e vendimit të komisionit, subjektit i lëshohet certifikata për të vepruar si operator i turizmit detar.

2. Certifikata, sipas modelit standard, nënshkruhet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin e subjektit aplikues dhe numrin e NIPT-it;
- b) numrin e licencës së operatorit turistik;
- c) adresën e subjektit;
- ç) llojin e aktivitetit të turizmit detar të miratuar;
- d) zonën e ushtrimit të aktivitetit të turizmit detar;
- dh) datën e lëshimit të certifikatës.

3. Për çdo ndryshim të të dhënave të operatorit të turizmit detar, subjekti është i detyruar, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, të informojë ministrinë përgjegjëse për turizmin.

4. Komisioni shqyrton rast pas rasti ndryshimet e të dhënave të operatorit të turizmit detar dhe vlerëson nëse subjekti duhet të kryejë një aplikim të ri.

5. Vlefshmëria e certifikatës së operatorit të turizmit detar është me afat 5-vjeçar, për zonën dhe aktivitetet e miratuara.

## VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

**Blendi Klosi**

## KËRKESE PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË “OPERATOR I TURIZMIT DETAR”

*(shtuar me udhëzimin nr. 1, datë 19.9.2023)*

| SEKSIONI A                           |  |
|--------------------------------------|--|
| Informacion mbi përfaqësuesin ligjor |  |
| Emri                                 |  |
| Mbiemri                              |  |
| Numër personal                       |  |
| Adresa                               |  |
| Numër telefoni                       |  |
| Adresë e-mail                        |  |
| Informacion mbi subjektin            |  |
| Emri tregtar                         |  |
| NIPT                                 |  |
| Numër licence                        |  |
| Adresa                               |  |
| Numër telefoni                       |  |
| Adresë email                         |  |
| SEKSIONI B                           |  |
| Zona e ushtrimit të aktivitetit      |  |

|                                                            |  |
|------------------------------------------------------------|--|
| Përshkrimi i aktivitetit /<br>aktiviteteve të parashikuara |  |
|------------------------------------------------------------|--|

## SEKSIONI C:

### Dokumentacion shoqërues:

- a) fotokopje të licensës XIII.1.B dhe një kopje e ekstraktit historik të QKR;
- b) kontratën e vendbazimit (lidhur mes subjektit aplikues dhe subjektit që administron vendbazimin;
- c) plani i menaxhimit të emergjencave (nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit);
- d) dokumenti që vërteton pronësinë apo kontratën noteriale (lidhur për përdorimin e mjeteve lundruese me qëllim aktivitetin detar);
- e) lista me të dhënat e mjeteve të lundrimit (në funksion të aktiviteteve që do të ofrohen):
  - lloji i mjetit;
  - numri i identifikimit;
  - flamuri (për mjetet me flamuj të huaj, një kopje të licensës VII.4.1);
  - kapaciteti;
  - viti i prodhimit;
  - personi përgjegjës;
  - numri i kontaktit;
- f) certifikata e sigurisë apo klasës së lëshuar nga shoqëria klasifikuese (sipas legjislacionit në fuqi për mjetet lundruese);
- g) policë sigurimi e mjetit lundrues, të përgjegjësishë ndaj palëve të tretat;
- h) deklarata e nënshkruar (nga subjekti) ku angazhohet të respektojë kriteret e përcaktuara në Kodin e Etikës së Operatorit të Turizmit Detar.